

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zyrtarë të Listës Serbe dyshohen për sulm ndaj rendit kushtetues dhe vepra të tjera penale
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/29/zyrtare-te-listes-serbe-dyshohen-per-sulm-ndaj-rendit-kushtetues-dhe-vepra-te-tjera-penale/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 11:46:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 11:46:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d29c4118509e5033c50072c0db6de7f2b466eebb749956cb566d6655a18f7ea8
TEKSTI	2f932bf317d394560eedc169630ee5bc52094ecb0b5389ad7da215c55fc6c95
PAMJA	a32190ce2a1f0e44f3de721b671c63772e77ead3175f937b85a22a6ad75d357b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	24ca60f767d6a5f33a8d0747da893eb936a72281728b2d2267d49c1671fa8598
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/24ca60f767d6a5f33a8d0747da893eb936a72281728b2d2267d49c1671fa8598>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

Zyrtarë të Listës Serbe dyshohen për sulm ndaj rendit kushtetues dhe vepra të tjera penale

13:46 : 29/09/2026 në RAJONI



Nënkryetari i Listës Serbe, Igor Simiq, ka bërë të ditur se ai dhe disa zyrtarë të tjerë të kësaj partie kanë marrë thirrje, në cilësinë e të dyshuarve, nga Departamenti për Hetimin e Terrorizmit i Prokurorisë Speciale.

Siç ka bërë të ditur në një postim në llogarinë e tij në Instagram, atyre u vihen në barrë katër vepra penale: bashkimi me qëllim të sulmit ndaj rendit kushtetues të Kosovës, sulm ndaj personit zyrtar, rrezikim i personit nën mbrojtje ndërkombëtare, pjesëmarrje në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizëm.

“Si gjithmonë, do t’i përgjigjem thirrjes, sepse nuk kam asgjë për të fshehur, i vetëdijshëm, ashtu si edhe ata që e kanë shkruar këtë, se nuk kam kryer asnjë vepër penale dhe se, si përfaqësues politik, e kam obligim të jem me popullin tim dhe të flas publikisht për vuajtjet e tij”, shkroi Simiq.

REL-i iu drejtua edhe Prokurorisë Speciale të Kosovës me pyetjet se për çfarë saktësisht dyshohen zyrtarët e Listës Serbe, për cilat ngjarje dhe sa persona dyshohen për veprat e përmendura penale. Ky institucion ende nuk ka kthyer përgjigje.

Lexo edhe:

[PDK-ja kërkon ndryshimin e Ligjit për Specialet para 6 tetorit](#)

[Identifikohen dy persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovë](#)

Simiq, i cili është edhe deputet në Kuvendin e Kosovës, vlerësoi se bëhet fjalë për “presion”, pasi tha se zyrtarëve të Listës Serbe u vijnë thirrje nga prokuroria e Kosovës “sa herë që e ngremë zërin për shkeljen e të drejtave individuale dhe kolektive të serbëve”.

Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve në Kosovë dhe gëzon mbështetjen e Beogradit.

Zyrtarët e kësaj partie edhe më herët kanë marrë thirrje nga Prokuroria Speciale për intervistim lidhur me “sulm ndaj rendit kushtetues të Kosovës”.

TË GJITHA



Zyrtarë të Listës Serbe dyshohen për sulm ndaj rendit kushtetues dhe vepra të tjera penale

13:46 : 29/09/2026



E përmendi Agasi në përgjime, Taulant Balla: Nuk komentoj persona që kanë probleme me drejtësinë

13:41 : 29/09/2026



Tenderi pa garë i KESH/ "Sigal" i Avni Ponarit merr 1.8 mln euro për të siguruar zyrat e Viola Haxhiademit

13:30 : 29/09/2026



Takimi me komisionin ndërparlamentar të BE, Balla: I sqaruar mirë për Zvernecin, investimi do bëhet!

13:20 : 29/09/2026



U arrestua pasi dhunoi Eduart Kuçin, Gjykata e Apelit jep vendimin për Jozefin Markun

13:06 : 29/09/2026



Gjendet i pajetë një person në Farkë, dyshimet e para

13:04 : 29/09/2026



Video-skandali/ Ura 40-milionëshe në Klos e ndërtuar nga "Bajrami N sh.p.k" shembet 10 ditë pas inaugurimit!

12:56 : 29/09/2026

Serbët në veri të Kosovës, gjatë viteve të mëparshme, kanë ngritur barrikada dhe kanë organizuar protesta për t'iu kundërvënë zbatimit të vendimeve të Qeverisë së Kosovës, ndërsa Lista Serbe i ka mbështetur rregullisht ato.

Prokuroria e Kosovës në qershor të këtij viti ka ngritur aktakuzë ndaj gjashtë personave për vendosjen e barrikadave në dhjetor të vitit 2022.

Këto barrikada u ngritën gjatë organizimit të zgjedhjeve lokale në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, pasi kryetarët e komunave dhanë dorëheqje në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës, me iniciativë të Listës Serbe.

Më pas pasuan tensione të shtuara, të cilat çuan në shpërthimin e dhunës në fund të majit të vitit 2023 në Zveçan, në veri të Kosovës, gjatë protestave të serbëve që kundërshtonin hyrjen e kryetarit shqiptar në ndërtesën e komunës, i cili kishte fituar zgjedhjet pas bojkotit nga serbët lokalë.

Edhe gjatë kësaj dhune, në të cilën u plagosën më shumë se 90 pjesëtarë të KFOR-it, në terren ishin të pranishëm zyrtarë të Listës Serbe. Organet e drejtësisë së Kosovës kanë proceduar rreth dhjetë persona lidhur me këto trazira, shumica prej të cilëve u liruan për t'u mbrojtur në liri me kusht, ndërsa disa shtetas të Serbisë u dëbuan nga Kosova.

Situata kulmoi me sulmin e armatosur të një grupi serbësh në Banjskë, afër Zveçanit, të cilin e udhëhoqi atëherë nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radoiqiq. Në këtë sulm u vra polici i Kosovës Afrim Bunjaku, ndërsa më pas u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova për këtë sulm e akuzoi edhe Serbinë, gjë që Beogradi zyrtar e mohoi./ REL

Etiketa: akuza kosove lista serbe

Lajme të lidhura



PDK-ja kërkon ndryshimin e Ligjit për Specialet para 6 tetorit

12:23 : 29/09/2026



Identifikohen dy persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovë

11:15 : 29/09/2026



Kosovë/ A do të ndryshohet ligji për Gjykatën Speciale?

22:52 : 28/09/2026



"Jo në emrin tim", Prishtina sërish në protestë për katërshen e UÇK-së

21:23 : 28/09/2026



Kosovë/ Partitë ende pa marrëveshje për presidentin e ri

17:10 : 28/09/2026



Aksion në veri të Kosovës/ Sekuestrohen armë, municion dhe uniforma ushtarake

22:29 : 27/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

